

R E L A C I O N

PËR

PROJEKTLIGJIN “PËR SHËRBIMET E KUJDESIT SOCIAL NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Projektligji “Për shërbimet e kujdesit social në Republikën e Shqipërisë” propozohet nga ministri i Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale (MSHMS) si një akt politik dhe social i qeverisë shqiptare që synon krijimin e një kuadri të ri ligjor për organizimin, financimin, sigurimin dhe ofrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror, si dhe përcaktimin e qartë të roleve dhe përgjegjësi të institucioneve qendrore dhe vendore dhe të ofruesve publikë e jopublikë të këtyre shërbimeve. Në qendër të këtij kuadri vendoset garantimi i aksesit universal në sistemin e shërbimeve të përkujdesit shoqëror, mbrojtja e të drejtave të përfituesve dhe promovimi i përfshirjes sociale.

Hartimi i këtij projektligji vjen në vijim të përvojës së krijuar gjatë zbatimit të ligjit nr. 121/2016 “Për shërbimet e përkujdesit shoqëror”, si dhe të zhvillimeve të rëndësishme në fushën e politikave sociale gjatë dekadës së fundit. Zbatimi i kuadrit ekzistues ka mundur konsolidimin e bazave të sistemit të shërbimeve sociale, decentralizimin e ofrimit të tyre, zgjerimin e shërbimeve komunitare dhe zhvillimin e mekanizmave të rinj të financimit, ndër të cilët Fondi Social. Në të njëjtën kohë, përvoja e zbatimit ka evidentuar nevojën për rishikimin e kuadrit ligjor në aspekte që lidhen me organizimin dhe funksionimin e sistemit, ndarjen e përgjegjësi ndërmjet niveleve të qeverisjes, planifikimin mbi bazën e nevojave, financimin dhe qëndrueshmërinë e shërbimeve, menaxhimin e rastit, sigurimin e cilësisë, zhvillimin e forcës së punës, digjitalizimin dhe mbrojtjen e të dhënave, si dhe mekanizmat e monitorimit, inspektimit dhe llogaridhënies.

Nevoja për një kuadër të ri ligjor është evidentuar edhe në kuadër të procesit të integritetit evropian të Shqipërisë. Në veçanti, në kuadër të negociatave për Kapitullin 19 “Politika Sociale dhe Punësimi”, zhvillimi i një sistemi më të gjerë, të aksesueshëm dhe të qëndrueshëm të shërbimeve sociale përbën një komponent të rëndësishëm të reformave në fushën e mbrojtjes sociale dhe përfshirjes sociale. Zgjerimi i gamës së shërbimeve përmes forcimit të mekanizmit të Fondit Social, zhvillimi i shërbimeve komunitare dhe krijimi i një kuadri të qëndrueshëm për kujdesin afatgjatë lidhen drejtpërdrejt me përmbushjen e angazhimeve të Shqipërisë në procesin negociues. Në të njëjtën kohë, zhvillimet në kuadër të

Kapitullit 23 dhe, veçanërisht, reforma e deinstitutionalizimit dhe forcimi i sistemit të mbrojtjes së fëmijëve, kërkojnë një sistem shërbimesh të aftë të ofrojë alternativa të bazuara në familje dhe komunitet dhe mbështetje të integruar për fëmijët dhe familjet në nevojë.

Procesi i hartimit të projektligjit është mbështetur në një analizë të thelluar të kuadrit ligjor ekzistues dhe të përvojës së zbatimit të tij. Analiza evidentoi se nevoja për ndërhyrje nuk kufizohej në amendimin e dispozitave të veçanta, por shtrihej në një pjesë të konsiderueshme të ligjit aktual dhe prekte vetë mënyrën e organizimit dhe funksionimit të sistemit. Për këtë arsye, u vlerësua se ndryshimet e pjesshme nuk do të ishin të mjaftueshme për të adresuar sfidat e identifikuara dhe për të mbështetur zhvillimin e mëtejshëm të sistemit, duke bërë të nevojshme hartimin e një ligji të ri.

Projektligji synon kështu kalimin nga një kuadër ligjor i fokusuar kryesisht në organizimin dhe kategorizimin e shërbimeve, drejt një **sistemi të integruar të përkujdesit shoqëror**, i cili vendos në qendër individin, familjen dhe nevojat e komunitetit. Në këtë qasje, shërbimi nuk konsiderohet më si një ndërhyrje e izoluar, por si pjesë e një procesi të integruar që përfshin identifikimin e nevojave, vlerësimin individual, referimin, planifikimin e mbështetjes, ofrimin e shërbimit, monitorimin dhe rivlerësimin.

Në këtë drejtim, projektligji synon të konsolidojë një sistem ku përgjegjësitë e qeverisjes qendrore dhe vendore janë të përcaktuara qartë, ku planifikimi i shërbimeve mbështetet në vlerësimin e nevojave dhe hartën e vulnerabilitetit, ku financimi lidhet me nevojat dhe qëndrueshmërinë e shërbimeve dhe ku ofruesit publikë e jopublikë veprojnë brenda një kuadri të përbashkët standardesh, monitorimi dhe llogaridhënieje. Projektligji parashikon gjithashtu që njësitë e vetëqeverisjes vendore të planifikojnë, zhvillojnë, administrojnë dhe garantojnë ofrimin e vazhdueshëm të shërbimeve në territorin e tyre, duke krijuar edhe Fondin Social Vendor si instrument financiar për mbështetjen e shërbimeve ekzistuese dhe zhvillimin e shërbimeve të reja.

Një objektiv i rëndësishëm i projektligjit është **zgjerimi i gamës së shërbimeve të përkujdesit shoqëror**, duke krijuar mundësi për forma më të diversifikuara dhe më të përshtatshme të mbështetjes. Përkufizimi i shërbimeve në projektligj i koncepton ato si tërësi ndërhyrjesh profesionale, mbështetëse, rehabilituese, mbrojtëse dhe zhvilluese, të organizuara nga ofrues publikë ose jopublikë, me synim përmirësimin e mirëqenies, autonomisë funksionale, përfshirjes sociale, mbrojtjes së të drejtave dhe cilësisë së jetës. Në këtë kuadër përfshihen, ndër të tjera, shërbimet e specializuara, tranzitore dhe lëvizëse, duke reflektuar nevojën për një sistem më fleksibël dhe më pranë përfituesit.

Një objektiv tjetër themelor është **garantimi i aksesit universal në sistemin e shërbimeve të përkujdesit shoqëror**. Në kuptim të projektligjit, aksesit universal nuk nënkupton përfitimin automatik të çdo individi nga çdo shërbim, por garantimin e mundësisë së çdo personi për të aksesuar sistemin, për t'iu vlerësuar nevojat dhe për t'u orientuar drejt mbështetjes së përshtatshme. E drejta për të përfituar shërbime lidhet me vlerësimin e nevojës dhe nivelit të cënueshmërisë sociale, ndërsa për shërbimet emergjente projektligji garanton akses për çdo individ në territorin e Republikës së Shqipërisë, pavarësisht statusit juridik, moshës, gjinisë apo gjendjes socio-ekonomike.

Në funksion të këtij objektivi, projektligji synon:

- të garantojë aksesin universal dhe të barabartë në sistemin e shërbimeve të përkujdesit shoqëror, duke siguruar që nevoja sociale të identifikohet dhe të vlerësohet në mënyrë profesionale dhe të orientuar drejt individit;
- të vendosë individin, familjen dhe nevojat e komunitetit në qendër të sistemit, përmes vlerësimit individual të nevojave, menaxhimit të rastit dhe planifikimit të mbështetjes;
- të zgjerojë dhe diversifikojë gamën e shërbimeve, duke përfshirë forma të reja të mbështetjes dhe duke forcuar shërbimet me bazë komunitare, jetesën e pavarur dhe kujdesin afatgjatë;
- të konsolidojë ndarjen e përgjegjësisë ndërmjet qeverisjes qendrore dhe vendore, duke forcuar rolin e njësisë të vetëqeverisjes vendore në planifikimin, financimin dhe garantimin e vazhdimësisë së shërbimeve;
- të krijojë një sistem më të qëndrueshëm dhe të orientuar drejt nevojave të financimit, përmes forcimit të Fondit Social dhe krijimit të Fondit Social Vendor, si dhe përmes një metodologjie të përcaktimit të kostos për njësi shërbimi. Drafti parashikon që kostoja për njësi të përcaktohet duke marrë në konsideratë llojin e shërbimit, standardet e ofrimit dhe nivelin e nevojave të përfituesve.
- të forcojë cilësinë, monitorimin dhe llogaridhënien e ofruesve, përmes standardeve, indikatorëve të performancës, monitorimit, inspektimit dhe vlerësimit të rezultateve;
- të sigurojë një rol të qartë dhe të rregulluar për ofruesit publikë dhe jopublikë, duke lidhur ofrimin e shërbimeve me respektimin e standardeve, kërkesave ligjore dhe, sipas rastit, licencimit;
- të zhvillojë një sistem të integruar të informacionit dhe menaxhimit të të dhënave, që mbështet planifikimin, menaxhimin e rasteve, monitorimin dhe vlerësimin e politikave, duke garantuar njëkohësisht parimet e ligjshmërisë, nevojshmërisë, proporcionalitetit dhe minimizimit të të dhënave në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale.

- të forcojë pjesëmarrjen, transparencën dhe llogaridhënien ndaj përfituesve, duke krijuar mekanizma për marrjen e ankesave, vlerësimin e kënaqësisë dhe publikimin e informacionit mbi cilësinë dhe performancën e shërbimeve.

Në përfundim, projektligji synon të krijojë bazën ligjore për një sistem të integruar, të qëndrueshëm dhe të orientuar drejt individit të shërbimeve të përkujdesit shoqëror, i cili ndërthur aksesin universal, vlerësimin e nevojave, diversifikimin e shërbimeve, financimin e qëndrueshëm, profesionalizimin, cilësinë, digjitalizimin dhe llogaridhënien. Në këtë mënyrë, kuadri i ri ligjor synon jo vetëm të adresojë problematikat e evidentuara gjatë zbatimit të ligjit nr. 121/2016, por edhe të krijojë kushtet për zhvillimin e mëtejshëm të sistemit në përputhje me angazhimet e Shqipërisë në procesin e integrimit evropian.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Projektligji hartohet në mbështetje të neneve 78 e 83, pika 1, të Kushtetutës.

Projektligji është në përputhje me vizionin e qeverisë shqiptare dhe në përmbushje të prioritetëve të shpallura në programin politik qeverisës 2025-2029, i cili identifikon familjen dhe fëmijët dhe grupet e tjera në nevojë si përparësi të politikave sociale, duke iu referuar tri shtyllave kryesore të programit qeverisës, dhe objektivave përkatës: Shtylla III: Mirëqenie për të gjithë, thekson se mirëqenia shihet si e drejtë për çdo shqiptar. Vizioni i Shqipërisë 2030 përcaktohet si një vend me fytyrë njerëzore dhe institucione që punojnë për qytetarin.

Hartimi i këtij projektligji është parashikuar në Programin Analitik të Akteve dhe lidhet me nevojën për rishikimin e kuadrit ligjor ekzistues për shërbimet e përkujdesit shoqëror, në funksion të përmirësimit të organizimit, financimit, ofrimit dhe sigurimit të cilësisë së shërbimeve sociale.

Projektligji mbështet objektivat e Strategjisë Kombëtare për Mbrojtjen Sociale 2024–2030, miratuar me vendimin nr.152, datë 13.3.2024, të Këshillit të Ministrave, veçanërisht në drejtim të zgjerimit dhe diversifikimit të shërbimeve sociale, rritjes së aksesueshmërisë dhe mbulimit territorial, forcimit të shërbimeve me bazë komunitare, përmirësimit të cilësisë së shërbimeve dhe krijimit të mekanizmave më të qëndrueshëm të financimit. Në këtë kuadër, forcimi i Fondit Social dhe krijimi i Fondit Social Vendor synojnë të mbështesin zgjerimin e

ofertës së shërbimeve në përputhje me nevojat e identifikuar në nivel vendor dhe me prioritetet kombëtare.

Projektligji lidhet gjithashtu me objektivat e procesit të negociimit për anëtarësimin e Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian, në veçanti me angazhimet në kuadër të Kapitullit 19 “Politika Sociale dhe Punësimi”. Zhvillimi i një sistemi të aksesueshëm dhe të qëndrueshëm të shërbimeve sociale, zgjerimi i gamës së shërbimeve të ofruara në komunitet, forcimi i mekanizmave të financimit dhe zhvillimi i kuadrit për kujdesin afatgjatë përbëjnë elemente të rëndësishme të reformës së mbrojtjes sociale dhe të përmbushjes së angazhimeve të Shqipërisë në këtë kapitull.

Në këtë drejtim, projektligji synon të krijojë bazën ligjore për një qasje më të integruar ndaj kujdesit social dhe kujdesit afatgjatë, në përputhje me Parimin 18 “Long-term care” të Shtyllës Evropiane të Drejtave Sociale, sipas të cilit çdo person ka të drejtë të aksesojë shërbime të kujdesit afatgjatë të përbalueshme dhe cilësore, veçanërisht shërbime të kujdesit në komunitet dhe në familje.

Projektligji kontribuon njëkohësisht në përmbushjen e angazhimeve në kuadër të Kapitullit 23 “Gjyqësori dhe të Drejtat Themelore”, veçanërisht në fushën e të drejtave të fëmijëve, mbrojtjes së personave në situatë vulnerabiliteti dhe procesit të deinstitutionalizimit. Zhvillimi i shërbimeve të bazuara në familje dhe komunitet, diversifikimi i alternativave të kujdesit dhe forcimi i mbështetjes për familjet në nevojë krijojnë një bazë më të përshtatshme për zbatimin e reformave të deinstitutionalizimit dhe për reduktimin gradual të varësisë nga kujdesi rezidencial.

Projektligji është në përputhje edhe me objektivat e politikave kombëtare për deinstitutionalizimit, decentralizimin dhe forcimin e rolit të njësisë të vetëqeverisjes vendore, duke qartësuar përgjegjësitë e bashkive për planifikimin, zhvillimin, administrimin dhe garantimin e vazhdimësisë së shërbimeve sociale në territor. Krijimi i Fondit Social Vendor dhe forcimi i planifikimit social vendor synojnë të lidhin më drejtpërdrejt politikat dhe burimet financiare me nevojat konkrete të komuniteteve.

Në aspektin e politikave për përfshirjen sociale dhe mosdiskriminimin, projektligji mbështet parimin e aksesit universal në sistemin e shërbimeve të përkujdesit shoqëror dhe synon të reduktojë pabarazitë në akses, duke i kushtuar vëmendje të veçantë individëve, familjeve dhe grupeve në situatë vulnerabiliteti. Kjo qasje është në përputhje me objektivat e politikave kombëtare për uljen e përjashtimit social dhe rritjen e mundësive për pjesëmarrje të barabartë në jetën sociale.

Në përputhje me zhvillimet e politikave publike për digjitalizimin dhe vendimmarrjen mbi bazën e evidencës, projektligji parashikon forcimin e sistemit të informacionit dhe të Regjistrit Elektronik Kombëtar të Shërbimeve të Përkujdesit Shoqëror. Këto mekanizma synojnë të përmirësojnë planifikimin, administrimin e rasteve, monitorimin e shërbimeve dhe vlerësimin e politikave, duke garantuar njëkohësisht respektimin e kërkesave të legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale.

Në tërësi, projektligji përbën një instrument të rëndësishëm për zbatimin e politikave kombëtare në fushën e mbrojtjes dhe përfshirjes sociale dhe për përmbushjen progresive të angazhimeve evropiane të Shqipërisë. Ai krijon bazën ligjore për kalimin drejt një sistemi më të integruar, të qëndrueshëm dhe të orientuar drejt individit, duke lidhur në një kuadër të vetëm planifikimin, financimin, ofrimin, cilësinë, monitorimin dhe mbrojtjen e të drejtave të përfituesve të shërbimeve të përkujdesit shoqëror.

Në mënyrë specifike, projektligji kontribuon gjithashtu në zbatimin e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ) të Agjendës 2030 të Kombeve të Bashkuara, veçanërisht të OZHQ 1 “Pa varfëri”, përmes forcimit të sistemeve të mbrojtjes sociale dhe zgjerimit të aksesit në shërbime sociale, si dhe të OZHQ 10 “Reduktimi i pabarazive”, përmes garantimit të aksesit universal, promovimit të përfshirjes sociale dhe reduktimit të pabarazive në aksesin ndaj shërbimeve. Në mënyrë të ndërlidhur, projektligji kontribuon në OZHQ 3 “Shëndet dhe mirëqenie”, përmes zhvillimit të shërbimeve që mbështesin mirëqenien dhe autonominë e individit, si dhe në OZHQ 16 “Paqe, drejtësi dhe institucione të forta”, përmes forcimit të mekanizmave të llogaridhënies, transparencës, pjesëmarrjes dhe mbrojtjes së të drejtave të përfituesve.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Hartimi i projektligjit “Për shërbimet e kujdesit social” është mbështetur në vlerësimin e zhvillimeve të sistemit të shërbimeve sociale gjatë periudhës së zbatimit të ligjit nr. 121/2016, në problematikat e evidentuara në praktikë, si dhe në nevojën për të përshtatur kuadrin ligjor me zhvillimin e politikave sociale, nevojat e reja të popullsisë dhe angazhimet e Republikës së Shqipërisë në procesin e integritetit evropian.

Ligji nr. 121/2016 krijoi bazën ligjore për organizimin e sistemit të shërbimeve të përkujdesit shoqëror dhe mundësoi zhvillime të rëndësishme në drejtim të decentralizimit, zgjerimit të shërbimeve komunitare, përfshirjes së ofruesve jopublikë dhe krijimit të mekanizmave të rinj të financimit. Megjithatë, përvoja e

zbatimit ka evidentuar nevojën për një qasje më të integruar, e cila të lidhë në mënyrë më të qartë identifikimin dhe vlerësimin e nevojave, planifikimin, financimin, ofrimin e shërbimeve, sigurimin e cilësisë, monitorimin dhe mbrojtjen e të drejtave të përfituesve.

Në këtë kuadër, prioriteti i projektligjit është kalimi nga një sistem të orientuar kryesisht drejt ofrimit të shërbimeve, në një sistem të integruar të përkuqdesit shoqëror, të orientuar drejt personit, familjes dhe komunitetit.

1. Zgjerimi dhe diversifikimi i gamës së shërbimeve

Një nga problematikat kryesore të identifikuara lidhet me nevojën për zgjerimin dhe diversifikimin e shërbimeve sociale në përputhje me profilet e ndryshme të nevojave sociale.

Projektligji synon të krijojë bazën ligjore për një gamë më të gjerë dhe më fleksibël shërbimesh, duke përfshirë forma të mbështetjes në familje dhe komunitet, shërbime të specializuara, tranzitore, lëvizëse, si dhe forma të kujdesit që mundësojnë mbështetjen e individit në mjedisin e tij të zakonshëm të jetesës.

Një rëndësi e veçantë i kushtohet kujdesit afatgjatë, si një fushë që kërkon një qasje të integruar dhe të qëndrueshme për personat që kanë nevojë për mbështetje të vazhdueshme në jetën e përditshme.

Efekti i pritshëm është rritja e mundësive të qytetarëve për të marrë shërbimin e përshtatshëm pranë familjes dhe komunitetit, reduktimi i varësisë nga format rezidenciale të kujdesit dhe krijimi gradual i një sistemi më të aftë për t'iu përgjigjur ndryshimeve demografike dhe sociale.

2. Garantimi i aksesit universal dhe vendosja e përfituesit në qendër

Një prioritet themelor i projektligjit është garantimi i aksesit universal në sistemin e shërbimeve të përkuqdesit shoqëror.

Në praktikë, nevojat sociale janë të ndryshme dhe jo çdo person ka nevojë për të njëjtin nivel apo lloj mbështetjeje. Për këtë arsye, projektligji e lidh aksesin me identifikimin dhe vlerësimin profesional të nevojave, duke synuar që personi të orientohet drejt shërbimit më të përshtatshëm.

Kjo qasje shoqërohet me forcimin e të drejtave të përfituesve, përfshirjen e tyre në vendimmarrje, respektimin e dinjitetit, privatësisë dhe konfidencialitetit, si dhe me krijimin e mekanizmave më të qartë të ankimimit dhe vlerësimit të kënaqësisë nga shërbimet.

Efekti i pritshëm është një sistem më i aksesueshëm, më gjithëpërfshirës dhe më i orientuar drejt rezultateve për individin, ku përfituesi nuk është vetëm marrës i një shërbimi, por pjesëmarrës në përcaktimin e mbështetjes që i nevojitet.

3. Forcimi i vlerësimit të nevojave dhe menaxhimit të rastit

Një tjetër prioritet është krijimi i një lidhjeje më të fortë ndërmjet nevojës sociale dhe shërbimit të ofruar.

Projektligji forcon procesin e identifikimit, vlerësimit dhe referimit të rasteve dhe vendos menaxhimin e rastit si mekanizëm për koordinimin e ndërhyrjeve dhe shërbimeve.

Kjo synon të shmangë fragmentarizimin e mbështetjes dhe të sigurojë që ndërhyrja të përshtatet me situatën konkrete të individit ose familjes.

Efekti i pritshëm është përmirësimi i koordinimit të shërbimeve, shmangia e mbivendosjeve dhe boshllëqeve në ofrim dhe rritja e efektivitetit të ndërhyrjeve sociale.

4. Forcimi i planifikimit social dhe i rolit të qeverisjes vendore

Një problematikë e rëndësishme lidhet me nevojën që planifikimi i shërbimeve të jetë më i lidhur me nevojat reale të popullsisë dhe me kapacitetet e territorit.

Projektligji synon të forcojë planifikimin social vendor dhe përdorimin e të dhënave dhe evidencës për përcaktimin e prioriteteve. Në këtë kuadër, Harta e Vulnerabilitetit Social shërben si një instrument për identifikimin dhe analizimin e nevojave sociale në territor dhe për orientimin e planifikimit dhe burimeve.

Njësitë e vetëqeverisjes vendore marrin një rol të qartë në planifikimin, zhvillimin, administrimin dhe garantimin e vazhdimësisë së shërbimeve sociale.

Efekti i pritshëm është një planifikim më i drejtë territorial, më i bazuar në evidencë dhe më i lidhur me profilet reale të vulnerabilitetit të popullsisë.

5. Reformimi i mekanizmave të financimit – Fondi Social Qendror dhe Fondi Social Vendor

Zgjerimi i shërbimeve sociale kërkon njëkohësisht mekanizma financimi të parashikueshëm dhe të qëndrueshëm.

Përvoja e zbatimit të Fondit Social ka treguar rëndësinë e tij në ngritjen dhe zgjerimin e shërbimeve, por ka evidentuar edhe nevojën për të kaluar drejt një

modeli më të strukturuar, që të mbështesë jo vetëm krijimin e shërbimeve të reja, por edhe vazhdimësinë dhe qëndrueshmërinë e tyre.

Projektligji parashikon Fondi Social Qendror dhe Fondin Social Vendor, duke synuar një ndarje më të qartë të funksioneve dhe përgjegjësiwe financiare ndërmjet nivelit qendror dhe atij vendor.

Fondi Social Qendror do të shërbejë si instrument për mbështetjen e prioritetëve kombëtare dhe ndërhyrjeve që kërkojnë mbështetje në nivel qendror, ndërsa Fondi Social Vendor do të mundësojë orientimin e burimeve drejt nevojave dhe prioritetëve të identifikuar në nivel vendor.

Një risi e rëndësishme është orientimi drejt një metodologjie më objektive dhe transparente të financimit, e lidhur me llojin e shërbimit, standardet e ofrimit, kostot për njësi dhe nivelin e nevojave të përfituesve.

Efekti i pritshëm është rritja e parashikueshmërisë dhe qëndrueshmërisë financiare të shërbimeve, reduktimi i pabarazive territoriale dhe përdorimi më efikas i burimeve publike.

6. Kujdesi afatgjatë si pjesë e sistemit të kujdesit shoqëror

Rritja e jetëgjatësisë, ndryshimet demografike dhe nevojat e personave që kërkojnë mbështetje të vazhdueshme e bëjnë kujdesin afatgjatë një komponent gjithnjë e më të rëndësishëm të sistemit social.

Projektligji krijon bazën për zhvillimin e kujdesit afatgjatë si një sistem mbështetjeje që synon të ruajë sa më gjatë autonominë, dinjitetin dhe pjesëmarrjen sociale të individit dhe të mbështesë familjen në ushtrimin e funksioneve të kujdesit.

Kjo qasje lidhet me zhvillimin e shërbimeve në familje dhe komunitet dhe me nevojën për të diversifikuar format e mbështetjes, përfshirë shërbimet që ndihmojnë familjarët kujdestarë dhe format e jetesës së pavarur.

Efekti i pritshëm është krijimi gradual i një sistemi të qëndrueshëm të kujdesit afatgjatë, i cili redukton barrën e kujdesit mbi familjet dhe promovon autonominë dhe përfshirjen e personave që kanë nevojë për mbështetje.

7. Forcimi i cilësisë dhe profesionalizimit të shërbimeve

Rritja e numrit të shërbimeve dhe diversifikimi i tyre duhet të shoqërohen me mekanizma efektivë për garantimin e cilësisë.

Projektligji forcon kuadrin e standardeve, monitorimit, inspektimit dhe vlerësimit të performancës së ofruesve. Në këtë kuadër, licencimi vijon të jetë një instrument i rëndësishëm për garantimin e përmbushjes së kërkesave minimale për ofrimin e shërbimeve, duke u lidhur më qartë me monitorimin dhe respektimin e standardeve.

Njëkohësisht, projektligji synon të forcojë profesionalizimin e punonjësve të shërbimeve sociale, zhvillimin e kompetencave profesionale dhe edukimin e vazhdueshëm.

Efekti i pritshëm është rritja e cilësisë dhe sigurisë së shërbimeve dhe konsolidimi i një force pune më të kualifikuar dhe profesionale.

8. Forcimi i llogaridhënies, inspektimit dhe sanksioneve

Përvoja e zbatimit ka evidentuar nevojën për mekanizma më të qartë të përgjegjshmërisë së aktorëve të sistemit.

Projektligji parashikon një kuadër më të plotë për monitorimin dhe inspektimin dhe përcakton rastet e përgjegjësisë administrative dhe masat përkatëse në rast të shkeljes së kërkesave ligjore dhe standardeve të shërbimit.

Efekti i pritshëm është rritja e llogaridhënies së ofruesve dhe institucioneve përgjegjëse dhe forcimi i mekanizmave për mbrojtjen e përfituesve dhe garantimin e cilësisë së shërbimeve.

9. Forcimi i mekanizmave të ankimimit dhe pjesëmarrjes së përfituesve

Mbrojtja e të drejtave të përfituesve kërkon që e drejta për të kundërshtuar një vendim apo për të paraqitur një ankesë të shoqërohet me procedura të qarta dhe efektive.

Projektligji synon të forcojë mekanizmat e ankimimit, transparencën e procedurave dhe mundësinë e përfituesve për të shprehur vlerësimin e tyre mbi shërbimet e marra.

Në këtë kuadër, mekanizmat e ankimimit dhe vlerësimit të kënaqësisë së përfituesve bëhen pjesë e qasjes së sigurimit të cilësisë dhe jo vetëm një procedurë administrative.

Efekti i pritshëm është rritja e mbrojtjes së të drejtave të përfituesve, transparencës dhe besimit në sistem.

10. Digjitalizimi dhe mbrojtja e të dhënave personale

Zhvillimi i një sistemi modern të shërbimeve sociale kërkon përdorimin e të dhënave të besueshme dhe në kohë për identifikimin e nevojave, menaxhimin e rasteve, planifikimin dhe monitorimin.

Projektligji parashikon zhvillimin dhe përdorimin e sistemeve elektronike të informacionit dhe Regjistrin Elektronik Kombëtar të Shërbimeve të Përkujdesit Shoqëror.

Në të njëjtën kohë, përpunimi i të dhënave personale, veçanërisht i të dhënave me karakter të ndjeshëm që lidhen me situatën sociale të individëve dhe familjeve, do të kryhet në përputhje me parimet dhe kërkesat e legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

Efekti i pritshëm është përmirësimi i cilësisë së informacionit dhe vendimmarrjes, rritja e transparencës dhe forcimi i mbrojtjes së të dhënave të përfituesve.

11. Forcimi i bashkëpunimit dhe pjesëmarrjes së aktorëve

Sistemi i përkujdesit shoqëror nuk mund të zhvillohet vetëm përmes ndërhyrjes së institucioneve publike. Ofruesit jopublikë, organizatat e shoqërisë civile, organizatat e personave me aftësi të kufizuara, grupet e përfituesve, profesionistët dhe institucionet e pavarura kanë një rol të rëndësishëm në identifikimin e problematikave dhe në zhvillimin e zgjidhjeve.

Për këtë arsye, projektligji parashikon krijimin e Këshillit Kombëtar të Shërbimeve të Përkujdesit Shoqëror, si një mekanizëm për dialog dhe këshillim në nivel kombëtar, ku të mundësohet pjesëmarrja e aktorëve të ndryshëm të sistemit dhe e shoqërisë civile.

Efekti i pritshëm është rritja e pjesëmarrjes së aktorëve në hartimin dhe zhvillimin e politikave dhe krijimi i një dialogu më të qëndrueshëm ndërmjet institucioneve, ofruesve dhe përfituesve.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektligji propozohet në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Projektligji është hartuar në përputhje me parimet dhe dispozitat kushtetuese, veçanërisht me parimin e barazisë dhe mosdiskriminimit, mbrojtjen sociale, mbrojtjen e familjes, të drejtat e fëmijëve, si dhe me parimet e decentralizimit dhe të ushtrimit të funksioneve publike në nivel sa më pranë qytetarëve.

Projektligji është në harmoni dhe plotëson kuadrin ligjor në fuqi në fushën e shërbimeve të përkujdesit shoqëror, mbrojtjes sociale, të drejtave të njeriut dhe organizimit të administrimit publik, në veçanti:

- Ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, në lidhje me organizimin dhe funksionimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, kompetencat e tyre dhe ushtrimin e funksioneve publike në nivel vendor. Ky harmonizim është veçanërisht i rëndësishëm për përcaktimin e përgjegjësive të njësive të vetëqeverisjes vendore në planifikimin, financimin, administrimin dhe ofrimin e shërbimeve sociale.
- Ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, i ndryshuar, në lidhje me financimin e funksioneve vendore dhe mekanizmat financiarë që mbështesin ofrimin e shërbimeve sociale në nivel vendor.
- Ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, në lidhje me procedurat e prokurimit dhe kontraktimit të shërbimeve të përkujdesit shoqëror nga institucionet publike dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore.
- Ligjin nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, i ndryshuar, në lidhje me garantimin e të drejtave të fëmijës, mbrojtjen e veçantë të fëmijëve në situatë vulnerabiliteti dhe ofrimin e shërbimeve në interesin më të lartë të fëmijës.
- Ligjin nr. 92/2025 “Për kujdesin alternativ në familje”, në lidhje me ofrimin e shërbimeve dhe mbështetjes për fëmijët në nevojë për kujdes dhe mbrojtje, si dhe me zhvillimin e alternativave të kujdesit të bazuara në familje dhe komunitet. Ligji nr. 92/2025 parashikon, ndër të tjera, edhe detyrime për bashkitë në drejtim të parandalimit të ndarjes së fëmijës nga familja dhe mbështetjes së familjeve.
- Ligjin nr. 64/2025 “Për barazinë gjinore”, në lidhje me garantimin e barazisë gjinore dhe integrimin e parimit të barazisë gjinore në politikat dhe shërbimet sociale. Ky ligj ka zëvendësuar ligjin nr. 9970/2008 “Për barazinë gjinore në shoqëri”.
- Ligjin nr. 11/2026 “Për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna ndaj grave dhe dhuna në familje”, në lidhje me ofrimin e shërbimeve të mbrojtjes dhe mbështetjes për viktimat dhe të mbijetuarat e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje.
- Ligjin nr. 10221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar, në lidhje me garantimin e barazisë dhe ndalimin e diskriminimit në aksesin dhe përfitimin e shërbimeve të përkujdesit shoqëror. Ky ligj përfshin

shprehimisht edhe ndalimin e diskriminimit në fushën e të mirave dhe shërbimeve.

- Ligjin nr. 124/2024 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, në lidhje me përpunimin, administrimin, ruajtjen dhe shkëmbimin e të dhënave personale të përfituesve dhe të subjekteve të tjera të përfshira në sistemin e shërbimeve sociale.
- Ligjin nr. 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”, në lidhje me garantimin e aksesueshmërisë, përfshirjes dhe pjesëmarrjes së barabartë të personave me aftësi të kufizuara në shërbimet e përkujdesit shoqëror.
- Ligjin nr. 108/2013 “Për të huajt”, i ndryshuar, në lidhje me aksesin dhe ofrimin e shërbimeve sociale për kategoritë e të huajve që përfshihen në fushën e zbatimit të projektligjit.
- Ligjin nr. 10171/2009 “Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në lidhje me kërkesat për ushtrimin e profesioneve të rregulluara që mund të angazhohen në ofrimin e shërbimeve të përkujdesit shoqëror dhe me garantimin e standardeve profesionale.
- Ligjin nr. 99/2024 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, në lidhje me organizimin dhe ushtrimin e funksioneve të inspektimit, procedurat e inspektimit, të drejtat e subjekteve të inspektuara dhe të drejtën e ankimit. Ky ligj përcakton një kuadër të unifikuar për inspektimin në nivel qendror dhe vendor dhe kërkon që dispozitat e projektligjit në këtë fushë të zbatohen në përputhje me parimet dhe procedurat e përgjithshme të inspektimit.
- Ligjin nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, në lidhje me procedurat administrative, të drejtën për informim, dëgjimin e palëve, marrjen e vendimeve administrative, ankimit administrativ dhe parimet e përgjithshme të veprimtarisë administrative.
- Ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, në lidhje me transparencën dhe të drejtën e përfituesve dhe të subjekteve të tjera të interesuara për akses në informacionin publik.
- Ligjin nr. 7961/1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, në lidhje me marrëdhëniet e punës dhe të drejtat e punonjësve të angazhuar në ofrimin e shërbimeve të përkujdesit shoqëror.
- Ligjin nr. 121/2016 “Për shërbimet e përkujdesit shoqëror”, i ndryshuar, i cili përbën kuadrin ligjor aktual që rregullon fushën e shërbimeve të përkujdesit shoqëror dhe që, me hyrjen në fuqi të këtij projektligji, parashikohet të shfuqizohet. Përvoja e zbatimit të këtij ligji dhe nevoja për rikonceptimin e kuadrit ligjor përbëjnë një nga bazat kryesore për hartimin e projektligjit të ri.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE* (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)

Projektligji është hartuar në përputhje me parimet dhe standardet evropiane në fushën e politikës sociale, përfshirjes sociale, mbrojtjes sociale dhe ofrimit të shërbimeve të kujdesit social. Në këtë fushë nuk ekziston një akt i vetëm i Bashkimit Evropian që të rregullojë në mënyrë të plotë dhe të drejtpërdrejtë shërbimet e kujdesit social. Për këtë arsye, projektligji synon përafrimin gradual të kuadrit kombëtar me parimet, standardet dhe politikat përkatëse të Bashkimit Evropian, si dhe me detyrimet që burojnë nga instrumentet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë.

Në kuadër të procesit të integritimit evropian, projektligji lidhet veçanërisht me Kapitullin 19 – Politika sociale dhe punësimi, në të cilin përfshihen fusha të tilla si përfshirja sociale, mbrojtja sociale, lufta kundër varfërisë dhe përjashtimit social, si dhe mbrojtja e grupeve në nevojë. Projektligji kontribuon në këtë drejtim përmes përcaktimit të një kuadri të integruar për organizimin, ofrimin, financimin, monitorimin dhe kontrollin e shërbimeve të kujdesit social.

Në hartimin e projektligjit janë marrë në konsideratë European Care Strategy (Strategjia Evropiane e Kujdesit), e miratuar nga Komisioni Evropian në vitin 2022, si dhe qasja evropiane për zhvillimin e shërbimeve të kujdesit afatgjatë. Strategjia Evropiane e Kujdesit synon rritjen e aksesit në shërbime kujdesi të përballueshme dhe cilësore, ndërsa kuadri evropian për LTC thekson rëndësinë e disponueshmërisë, aksesueshmërisë, përballueshmërisë dhe cilësisë së shërbimeve të kujdesit afatgjatë.

Në këtë kuadër, projektligji parashikon kujdesin afatgjatë si pjesë të sistemit të shërbimeve të kujdesit social, duke synuar zhvillimin e shërbimeve rezidenciale, komunitare dhe në familje, si dhe shërbimeve të integruara dhe mbështetëse, në funksion të ruajtjes së autonomisë, funksionalitetit, përfshirjes sociale dhe cilësisë së jetës së përfituesve. Kjo qasje është në përputhje me orientimin evropian për zhvillimin e shërbimeve të kujdesit afatgjatë dhe forcimin e shërbimeve të bazuara në komunitet. Komisioni Evropian e lidh shprehimisht LTC me ofrimin e shërbimeve cilësore dhe të përballueshme dhe me mbështetjen e personave që kanë nevojë për ndihmë në aktivitetet e jetës së përditshme.

Në hartimin e projektligjit janë marrë gjithashtu në konsideratë Shtylla Evropiane e të Drejtave Sociale, veçanërisht parimet që lidhen me mbështetjen për fëmijët, mbrojtjen sociale, të drejtën për shërbime të kujdesit afatgjatë, përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara dhe aksesin në shërbime sociale cilësore.

Projektligji është gjithashtu në përputhje me parimet e Kartës së të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian, veçanërisht me dispozitat që lidhen me dinjitetin njerëzor, mosdiskriminimin, të drejtat e fëmijës, integritetin e personave me aftësi të kufizuara dhe të drejtën për mbrojtje sociale dhe ndihmë sociale.

Në lidhje me personat me aftësi të kufizuara, projektligji merr në konsideratë parimet e Konventës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, veçanërisht në drejtim të autonomisë, përfshirjes në komunitet, pjesëmarrjes në vendimmarrje, zgjedhjes dhe ofrimit të mbështetjes së përshtatur sipas nevojave individuale.

Në lidhje me fëmijët, projektligji respekton parimin e interesit më të lartë të fëmijës, të drejtën e fëmijës për t'u dëgjuar dhe për t'u përfshirë në vendimmarrje, si dhe parimet e mbrojtjes dhe përkujdesjes së përshtatshme, në përputhje me nenin 24 të Kartës së të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian dhe instrumentet ndërkombëtare për të drejtat e fëmijës.

Në përfundim, projektligji nuk synon përafrimin me një direktivë ose rregullore të veçantë të Bashkimit Evropian, por kontribuon në përafrimin gradual të legjislacionit shqiptar me acquis-in dhe politikat evropiane në fushën e politikës sociale dhe punësimit, veçanërisht në kuadër të Kapitullit 19, si dhe me orientimet e Strategjisë Evropiane të Kujdesit dhe kuadrin evropian për kujdesin afatgjatë.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Ky projektligj krijon një kuadër të plotë ligjor për organizimin, ofrimin, financimin, monitorimin dhe zhvillimin e shërbimeve të përkujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë. Ai synon të garantojë një sistem të integruar, të aksesueshëm, cilësor dhe të qëndrueshëm të shërbimeve të përkujdesit shoqëror, të orientuar drejt nevojave të individit, familjes dhe komunitetit.

Projektligji vendos në qendër të sistemit përfituesin e shërbimit, duke synuar respektimin e dinjitetit, të drejtave, autonomisë, zgjedhjes, pjesëmarrjes dhe përfshirjes sociale të tij. Ai parashikon një qasje të integruar të shërbimeve, duke nxitur bashkëpunimin ndërmjet sektorit social, shëndetësor, arsimor, të punësimit dhe sektorëve të tjerë relevantë.

Një element i rëndësishëm i projektligjit është forcimi i shërbimeve të bazuara në komunitet dhe në familje, duke synuar reduktimin gradual të varësisë nga modelet rezidenciale dhe mbështetjen e jetesës së pavarur, përfshirjes sociale dhe vazhdimësisë së shërbimeve për përfituesit.

Projektligji përcakton gjithashtu përgjegjësitë e institucioneve qendrore dhe vendore, rregullat për ofruesit publikë dhe jopublikë, licencimin dhe standardet e cilësisë, mekanizmat e financimit, menaxhimin financiar dhe kontrollin, si dhe kuadrin për zhvillimin e forcës së punës në fushën e shërbimeve të përkujdesit shoqëror.

Një pjesë e veçantë i kushtohet zhvillimit profesional të personelit, certifikimit dhe licencimit sipas natyrës së profesionit, zhvillimit profesional të vazhdueshëm dhe supervizimit profesional, me qëllim garantimin e cilësisë dhe sigurisë së shërbimeve.

Projektligji parashikon gjithashtu përdorimin e sistemeve elektronike të informacionit, regjistrave përkatës dhe mekanizmave të monitorimit dhe raportimit, me qëllim përmirësimin e planifikimit, menaxhimit, transparencës dhe vlerësimit të sistemit të shërbimeve të përkujdesit shoqëror.

Projektligji është i përbërë nga **56 nene**, të organizuara në pjesë dhe krerë, si më poshtë:

Neni 1 - Qëllimi i ligjit. Ky nen përcakton objektivin e projektligjit, i cili konsiston në krijimin e kuadrit të plotë ligjor për organizimin, financimin, sigurimin dhe ofrimin e shërbimeve të kujdesit social, duke përcaktuar rolet dhe përgjegjësitë e institucioneve përgjegjëse. Dispozita synon garantimin e aksesit universal në shërbime dhe promovimin e përfshirjes sociale të individëve dhe grupeve në nevojë.

Neni 2 – Fusha e zbatimit. Ky nen përcakton elementet që rregullohen nga projektligji, duke përfshirë të drejtat dhe detyrimet e përfituesve, organizimin dhe funksionimin e sistemit, kategorizimin e shërbimeve, standardet e cilësisë, rolin e ofruesve publikë dhe jopublikë, organizimin e forcës së punës dhe sistemin e informacionit. Dispozita synon të përcaktojë në mënyrë të qartë fushën materiale të ligjit dhe marrëdhëniet juridike që ai rregullon.

Neni 3 – Përkufizime. Ky nen përmban terminologjinë bazë të përdorur në projektligj dhe përcakton kuptimin ligjor të koncepteve kryesore që lidhen me sistemin e shërbimeve të kujdesit social. Në këtë nen përfshihen, ndër të tjera, përkufizimet për kujdesin afatgjatë, kujdesin alternativ, kujdesin zëvendësues të përkohshëm, kujdestarin, ndihmësin personal, ofruesit publikë dhe jopublikë, shërbimet komunitare, shërbimet në familje, shërbimet rezidenciale, shërbimet e integruara, shërbimet e specializuara, shërbimet tranzitore, shërbimet lëvizëse, standardet e cilësisë dhe sistemin elektronik të informacionit.

Neni 4 – *Parimet*. Ky nen përcakton bazën normative mbi të cilën ndërtohet sistemi i shërbimeve të kujdesit social. Krahas parimeve tradicionale, si universaliteti, mosdiskriminimi dhe decentralizimi, dispozita përfshin edhe parimin e deinstitutionalizimit, pjesëmarrjes së përfituesit, integritet ndërsëktorial, fuqizimit të individit dhe ofrimit të shërbimeve të bazuara në nevojat individuale. Qëllimi është orientimi i gjithë sistemit drejt qasjeve bashkëkohore të mbrojtjes sociale dhe të drejtave të njeriut.

Neni 5 – *Përfituesit*. Ky nen përcakton kategoritë e individëve dhe grupeve që kanë të drejtë të përfitojnë shërbime të kujdesit social dhe kriterin bazë të përfitimit, që është vlerësimi i nevojave dhe nivelit të vulnerabilitetit. Dispozita identifikon grupet prioritare, përfshirë fëmijët pa kujdes prindëror, personat me aftësi të kufizuara, të moshuarit, viktimat e dhunës dhe trafikimit, si dhe garanton akses në shërbime emergjente për çdo person që ndodhet në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Neni 6 – *Të drejtat e përfituesve*. Ky nen kodifikon të drejtat themelore të përfituesve të shërbimeve të kujdesit social. Përfituesve u garantohet trajtim me dinjitet dhe pa diskriminim, informim i plotë, pjesëmarrje në proceset e vlerësimit dhe planifikimit të mbështetjes, mbrojtja e të dhënave personale, e drejta për ankesa dhe akses në shërbime cilësore, të sigurta dhe të individualizuara. Dispozita synon të vendosë përfituesin në qendër të sistemit të shërbimeve.

Neni 7 – *Detyrimet e përfituesve*. Ky nen përcakton detyrimet minimale që lidhen me bashkëpunimin e përfituesit gjatë procesit të vlerësimit dhe ofrimit të shërbimit. Përfituesi detyrohet të japë informacion të saktë, të respektojë rregullat e funksionimit të shërbimeve dhe të kontribuojë në zbatimin e planit individual të mbështetjes. Gjithashtu, dispozita garanton se mosushtimi i këtyre detyrimeve nuk mund të përdoret automatikisht për kufizimin e të drejtave të tij.

Neni 8 – *Sistemi i shërbimeve të kujdesit social*. Ky nen përcakton strukturën dhe organizimin e sistemit kombëtar të shërbimeve të kujdesit social. Dispozita ndan qartë përgjegjësitë ndërmjet nivelit qendror, njësisë të vetëqeverisjes vendore dhe ofruesve të shërbimeve, duke konsoliduar modelin e decentralizuar të ofrimit të tyre dhe duke përcaktuar kategoritë e ofruesve publikë dhe jopublikë.

Neni 9 – *Ministria përgjegjëse për çështjet sociale*. Ky nen përcakton ministrinë si autoritetin përgjegjës për hartimin e politikave, strategjive, standardeve dhe kuadrit rregullator të sistemit. Gjithashtu, i ngarkon asaj kompetenca për koordinimin e aktorëve institucionalë, programimin e fondeve, administrimin e mekanizmave të financimit dhe mbikëqyrjen e sistemit kombëtar të informacionit social.

Neni 10 – Agjencia përgjegjëse për shërbimet e kujdesit social. Ky nen rregullon statusin dhe funksionet e agjencisë si institucion teknik përgjegjës për zbatimin e politikave. Agjencia ngarkohet me vlerësimin e nevojave në nivel kombëtar dhe vendor, administrimin e regjistrit elektronik kombëtar, trajnimin dhe ngritjen e kapaciteteve të forcës së punës, monitorimin e standardeve të cilësisë dhe raportimin periodik mbi funksionimin e sistemit.

Neni 11 – Struktura përgjegjëse për inspektimin. Ky nen përcakton bazën ligjore të inspektimit të shërbimeve të kujdesit social. Struktura inspektuese verifikon respektimin e ligjit dhe standardeve të cilësisë, kryen kontrole në terren, kërkon masa korrigjuese, propozon masa administrative dhe shqyrton ankesat që lidhen me ofrimin e shërbimeve. Dispozita garanton ushtrimin e pavarur të funksioneve inspektuese.

Neni 12 – Qarku. Ky nen përcakton rolin e qarkut si mekanizëm rajonal koordinues. Qarku siguron bashkërendimin e politikave sociale ndërmjet bashkive, mbështet hartimin e planeve rajonale sociale dhe organizon shërbime me karakter ndërbashkiak ose rajonal kur këto nuk mund të ofrohen në mënyrë efektive nga një bashki e vetme.

Neni 13 – Bashkia. Ky nen përbën dispozitën kryesore që përcakton përgjegjësitë e njësive të vetëqeverisjes vendore në sistem. Bashkia përgjigjet për identifikimin dhe vlerësimin e nevojave, hartimin e Planit Social Vendor, krijimin dhe administrimin e Fondit Social Vendor, organizimin dhe financimin e shërbimeve, monitorimin e cilësisë dhe ngritjen e strukturave të nevojshme për ofrimin e tyre. Dispozita konsolidon rolin e bashkisë si autoriteti kryesor i ofrimit të shërbimeve sociale.

Neni 14 – Njësia e Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit të Rastit. Ky nen krijon mekanizmin bazë vendor për identifikimin, vlerësimin dhe referimin e rasteve. Njësia përgjigjet për vlerësimin fillestar dhe të thelluar të nevojave, përcaktimin e nivelit të riskut, koordinimin e referimeve, monitorimin e rasteve dhe mbështetjen e proceseve të planifikimit social në bashki. Në këtë mënyrë institucionalizohet funksioni i “portës hyrëse” në sistemin e shërbimeve të kujdesit social.

Neni 15 – Ofruesit e shërbimeve të kujdesit social. Ky nen përcakton statusin dhe detyrimet e ofruesve publikë dhe jopublikë të shërbimeve të kujdesit social. Ofruesit janë të detyruar të zbatojnë standardet e cilësisë, të mbrojnë të drejtat e përfituesve, të sigurojnë konfidencialitetin e të dhënave dhe të bashkëpunojnë me strukturat përgjegjëse të sistemit. Ata gjithashtu i nënshtrohen monitorimit, vlerësimit dhe inspektimit nga autoritetet kompetente.

Neni 16 – *Këshilli Kombëtar për Shërbimet e Kujdesit Social.* Ky nen krijon Këshillin Kombëtar për Shërbimet e Kujdesit Social si organ këshillimor dhe koordinues ndërinstitutional. Këshilli ka për mision të mbështesë koordinimin e politikave, harmonizimin e ndërhyrjeve dhe formulimin e rekomandimeve strategjike për zhvillimin e sistemit, pa ushtruar kompetenca ekzekutive apo financiare. Përbërja e tij siguron përfaqësimin e institucioneve qendrore, njësive të vetëqeverisjes vendore, ofruesve të shërbimeve, urdhrave profesionalë dhe organizatave të shoqërisë civile.

Neni 17 – *Kategoritë e shërbimeve të kujdesit social.* Ky nen përcakton organizimin dhe klasifikimin e shërbimeve të kujdesit social si një sistem i integruar mbështetjeje, mbrojtjeje dhe fuqizimi të përfituesve. Dispozita vendos prioritetin e ofrimit të shërbimeve në familje dhe komunitet, në përputhje me parimin e deinstitutionalizimit, dhe klasifikon shërbimet sipas mjedisit të ofrimit në: shërbime rezidenciale, komunitare dhe në familje, shërbime në distancë, kujdes alternativ për fëmijët dhe shërbime të jetesës së pavarur. Gjithashtu, përcaktohet që shërbimet mund të ofrohen në forma të integruara, multidisiplinare dhe ndërsektoriale.

Neni 18 – *Standardet bazë të cilësisë së shërbimeve të kujdesit social.* Ky nen përcakton elementet kryesore të standardeve bazë të cilësisë që duhet të përmbushin të gjitha shërbimet e kujdesit social. Standardet përfshijnë mbrojtjen e të drejtave të përfituesve, organizimin institucional, burimet njerëzore, infrastrukturën, menaxhimin e rasteve, mbrojtjen e të dhënave, sigurinë, gatishmërinë për emergjencë dhe mekanizmat e monitorimit e vlerësimit të cilësisë. Dispozita synon krijimin e një niveli minimal dhe të detyrueshëm cilësie në të gjithë sistemin.

Neni 19 – *Pranimi në shërbimet e kujdesit social.* Ky nen rregullon procedurën e aksesimit dhe pranimit në shërbimet e kujdesit social. Ai përcakton subjektet që mund të paraqesin kërkesën, kompetencën e bashkisë për trajtimin e saj, procesin e vlerësimit dhe vendimmarrjes, si dhe procedurat për rastet kur shërbimi nuk disponohet në territorin e bashkisë. Gjithashtu, parashikohen mekanizma të posaçëm për rastet emergjente dhe parimet që duhet të udhëheqin procesin e pranimit.

Neni 20 – *Vlerësimi i nevojave.* Ky nen përcakton vlerësimin e nevojave si procesin bazë profesional për identifikimin e nevojave sociale të individëve dhe familjeve. Dispozita vendos parimin e vlerësimit të integruar, multidisiplinar dhe të përqendruar te personi, duke përcaktuar format e ndryshme të vlerësimit,

mënyrën e përdorimit të rezultateve të tij dhe rishikimin periodik të vlerësimit në përputhje me ndryshimet e situatës së përfituesit.

Neni 21 – *Menaxhimi i rastit.* Ky nen institucionalizon menaxhimin e rastit si mekanizmin kryesor për koordinimin e ndërhyrjeve dhe shërbimeve për përfituesit. Ai përcakton rolin e strukturave vendore në koordinimin e rastit, përdorimin e planit individual të mbështetjes, bashkëpunimin ndërinstitutional dhe menaxhimin e tranzicioneve ndërmjet shërbimeve të ndryshme. Dispozita synon të sigurojë vazhdimësi, koordinim dhe efektivitet në mbështetjen e përfituesve.

Neni 22 – *Licencimi i shërbimeve të kujdesit social.* Ky nen përcakton detyrimin që çdo shërbim i kujdesit social i ofruar nga subjekte publike ose jopublike t'i nënshtrohet procedurave të licencimit. Dispozita përcakton bazën ligjore për kriteret, dokumentacionin dhe procedurat që duhet të përmbushin ofruesit për ushtrimin e veprimtarisë.

Neni 23 – *Sistemi i sigurimit të cilësisë.* Ky nen krijon kornizën e përgjithshme të sigurimit të cilësisë në sistemin e shërbimeve të kujdesit social. Përveç standardeve bazë dhe monitorimit, ai parashikon akreditimin si një mekanizëm të veçantë dhe vullnetar të avancimit të cilësisë, duke e dalluar qartë atë nga procesi i licencimit. Dispozita synon të nxisë përmirësimin e vazhdueshëm dhe konkurrueshmërinë pozitive të ofruesve të shërbimeve.

Neni 24 – *Monitorimi i shërbimeve të kujdesit social.* Ky nen përcakton monitorimin si instrumentin kryesor për verifikimin e përputhshmërisë së shërbimeve me standardet, objektivat dhe rezultatet e pritshme. Dispozita rregullon subjektet përgjegjëse për monitorimin, indikatorët e performancës, mbledhjen dhe analizën e të dhënave, si dhe raportimin periodik mbi ecurinë e sistemit.

Neni 25 – *Raportimi dhe vlerësimi i performancës.* Ky nen vendos detyrimin e ofruesve për raportimin periodik të të dhënave dhe rezultateve të shërbimeve. Dispozita synon të sigurojë bazën e nevojshme për planifikimin e politikave sociale, identifikimin e nevojave për ndërhyrje të reja dhe përmirësimin e efektivitetit të sistemit.

Neni 26 – *Inspektimi i shërbimeve të kujdesit social.* Ky nen rregullon procedurat e inspektimit të shërbimeve, format e inspektimit të planifikuar, të bazuar në risk dhe të papritur, si dhe kompetencat e autoriteteve inspektuese. Dispozita synon të garantojë respektimin e ligjit, standardeve të cilësisë dhe mbrojtjen e të drejtave të përfituesve.

Neni 27 – Masat korigjuese dhe ndjekja e rekomandimeve. Ky nen përcakton masat që mund të vendosen ndaj ofruesve kur konstatohen shkelje gjatë inspektimit. Masat përfshijnë përmirësimin e kushteve të shërbimit, trajnimin e personelit, korigjimin e procedurave dhe, në raste të rënda, kufizimin ose pezullimin e aktivitetit. Dispozita krijon mekanizmin e reagimit dhe korigjimit të mangësive të identifikuara.

Neni 28 – Transparenca dhe përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë. Ky nen garanton transparencën e sistemit përmes raportimit, informimit publik dhe përfshirjes së përfituesve në vlerësimin e cilësisë së shërbimeve. Ai synon të krijojë një kulturë llogaridhënieje dhe përmirësimi të vazhdueshëm të shërbimeve sociale.

Neni 29 – Publikimi i informacionit mbi cilësinë e shërbimeve. Ky nen përcakton detyrimin e institucioneve përgjegjëse për publikimin e të dhënave lidhur me funksionimin, performancën, monitorimin, licencimin dhe akreditimin e shërbimeve. Dispozita synon rritjen e transparencës dhe informimit të publikut.

Neni 30 – Regjistri Elektronik Kombëtar i Shërbimeve Shoqërore. Ky nen krijon regjistrin elektronik kombëtar si infrastrukturen kryesore të informacionit të sistemit të shërbimeve sociale. Dispozita përcakton subjektet që kanë akses, përgjegjësitë për administrimin e të dhënave dhe funksionet e regjistrit në menaxhimin e rasteve, monitorimin dhe raportimin.

Neni 31 – Përpunimi, mbrojtja dhe përdorimi i të dhënave. Ky nen vendos rregullat për mbrojtjen, përdorimin dhe shkëmbimin e të dhënave personale të përfituesve, duke garantuar respektimin e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale dhe kufizimin e aksesit sipas nevojës funksionale.

Neni 32 – Parimet e financimit. Ky nen përcakton parimet që drejtojnë financimin e sistemit, duke përfshirë aksesin e barabartë, orientimin sipas nevojave, transparencën, llogaridhënien dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimeve.

Neni 33 – Burimet e financimit. Ky nen identifikon burimet financiare që mbështesin sistemin e shërbimeve të kujdesit social, duke përfshirë fondet e shtetit, fondet vendore, kontributet e përfituesve, grantet dhe donacionet.

Neni 34 – Mekanizmat e financimit të shërbimeve. Ky nen rregullon mënyrën e financimit të shërbimeve sociale në nivel qendror dhe vendor, kriteret për shpërndarjen e fondeve, marrëveshjet e financimit dhe lidhjen ndërmjet financimit dhe performancës së shërbimeve.

Neni 35 – Fondi Social. Ky nen rregullon Programin e Fondit Social si mekanizëm financiar për mbështetjen e njësive të vetëqeverisjes vendore në

ngritjen, zgjerimin dhe garantimin e qëndrueshmërisë së shërbimeve të kujdesit social.

Neni 36 – *Kostot për njësi të shërbimeve.* Ky nen përcakton metodologjinë për llogaritjen e kostove referuese të shërbimeve sociale dhe lidhjen e financimit me tipologjinë e shërbimit dhe nivelin e nevojave të përfituesve.

Neni 37 – *Tarifat dhe kontributet e përfituesve.* Ky nen rregullon rastet kur përfituesit kontribuojnë financiarisht në marrjen e shërbimeve sociale dhe kriteret për përcaktimin e tarifave sipas aftësisë paguese dhe natyrës së shërbimit.

Neni 38 – *Menaxhimi financiar dhe raportimi.* Ky nen përcakton detyrimet e ofruesve të financuar me fonde publike për administrimin financiar, mbajtjen e evidencave, raportimin financiar dhe raportimin e performancës.

Neni 39 – *Kontrolli dhe auditimi.* Ky nen rregullon kontrollin financiar dhe auditimin e përdorimit të fondeve publike, si dhe masat që mund të merren në rast të konstatimit të parregullsive ose keqpërdorimit të fondeve.

Neni 40 – *Puna në fushën e shërbimeve të kujdesit social.* Ky nen vendos parimet bazë për ushtrimin e profesionit në sektorin e shërbimeve sociale, duke kërkuar kualifikime të përshtatshme, certifikim ose licencim sipas natyrës së profesionit dhe respektimin e standardeve profesionale.

Neni 41 – *Kushtet për ushtrimin e profesionit.* Ky nen përcakton kushtet që duhet të plotësojnë profesionistët për të ushtruar profesionin e tyre, duke dalluar profesionet e rregulluara nga figurat e tjera profesionale.

Neni 42 – *Të drejtat dhe detyrimet e profesionistëve.* Ky nen përcakton standardet etike, profesionale dhe organizative që duhet të respektojnë profesionistët e shërbimeve sociale në marrëdhëniet me përfituesit dhe institucionet.

Neni 43 – *Zhvillimi profesional i vazhdueshëm.* Ky nen vendos detyrimin për zhvillim profesional të vazhdueshëm dhe përcakton rolin e institucioneve përgjegjëse në organizimin e trajnimeve, edukimit në vazhdim dhe supervizimit profesional.

Neni 44 – *Supervizimi profesional.* Ky nen rregullon organizimin e supervizimit profesional si instrument për garantimin e cilësisë së shërbimeve, mbështetjen profesionale të stafit dhe respektimin e standardeve etike.

Neni 45 – *Administrimi i të dhënave për profesionistët.* Ky nen përcakton administrimin e informacionit mbi profesionistët e sistemit të shërbimeve sociale për qëllime planifikimi, monitorimi dhe zhvillimi të burimeve njerëzore.

Neni 46 – *Mbrojtja e shëndetit dhe mirëqenies së punonjësve.* Ky nen vendos detyrime për punëdhënësit në lidhje me sigurinë, shëndetin, mbrojtjen nga mbingarkesa profesionale dhe mbështetjen psikologjike të personelit.

Neni 47 – *E drejta për ankim.* Ky nen garanton të drejtën e çdo përfituesi ose përfaqësuesi të tij për të paraqitur ankesa lidhur me cilësinë, aksesin ose respektimin e të drejtave në shërbimet e kujdesit social dhe parashikon mbrojtjen nga çdo formë hakmarrjeje ose diskriminimi.

Neni 48 – *Procedura e shqyrtimit të ankesave.* Ky nen rregullon detyrimet e institucioneve dhe ofruesve për trajtimin e ankesave, afatet e shqyrtimit dhe procedurat e përshpejtuara për rastet që lidhen me sigurinë dhe integritetin e përfituesve.

Neni 49 – *Shkeljet administrative dhe masat administrative.* Ky nen përcakton rastet e kundërvajtjeve administrative dhe llojet e masave që mund të merren ndaj ofruesve ose institucioneve që shkelin detyrimet ligjore, përfshirë gjobat, masat korrigjuese dhe referimin për procedura të tjera ligjore.

Neni 50 – *Ankimi administrative.* Ky nen rregullon të drejtën e përfituesve dhe personave të interesuar për të kundërshtuar aktet administrative të nxjerra në zbatim të ligjit, sipas procedurave të Kodit të Procedurave Administrative.

Neni 51 – *E drejta për t’iu drejtuar gjykatës.* Ky nen garanton mbrojtjen gjyqësore ndaj akteve, veprimeve ose mosveprimeve administrative të autoriteteve përgjegjëse për zbatimin e ligjit.

Neni 52 – *Masat kalimtare.* Ky nen përcakton periudhën dhe rregullat tranzitore për përshtatjen e ofruesve ekzistues dhe të sistemit me kërkesat e ligjit të ri.

Neni 53 – *Masat kalimtare për transformimin e shërbimeve rezidenciale.* Ky nen rregullon procesin gradual të transformimit të shërbimeve rezidenciale ekzistuese në përputhje me parimin e deinstitutionalizimit dhe zhvillimin e alternativave komunitare dhe familjare.

Neni 54 – *Shfuqizimet.* Ky nen parashikon shfuqizimin e ligjit nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe të akteve nënligjore të dala në zbatim të tij.

Neni 55 – *Aktet nënligjore.* Ky nen përcakton detyrimin e Këshillit të Ministrave dhe ministrit përgjegjës për çështjet sociale për nxjerrjen e akteve nënligjore të nevojshme për zbatimin e ligjit brenda afateve të përcaktuara.

Neni 56 – *Hyrja në fuqi.* Ky nen përcakton se ligji hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E PROJEKTAKTIT

Këshilli i Ministrave dhe ministria përgjegjëse për çështjet sociale ngarkohen për nxjerrjen e akteve nënligjore në zbatim të këtij ligji.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKAKTIT

Projektligji është hartuar në kuadër të punës së realizuar nga grupi i punës i ngritur me urdhrin nr.156, datë 28.3.2025, “Për ngritjen dhe funksionimin e grupit teknik të punës për hartimin e ndryshimeve të ligjit nr.121/2016, “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, hartimin e projektligjit të kujdesit alternativ dhe hartimin e planit të procesit të transformimit të qendrave rezidenciale të përkujdesjes shoqërore për fëmijë 2025-2026”.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Shpenzimet për zbatimin e këtij projektligji akordohen dhe përballohen nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe programet buxhetore përkatëse.

KËSHILLI I MINISTRAVE